



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

ADMINISTRIMIN E LIKUIDITETIT PËR FONDIN E INVESTIMEVE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 21, datë 06.02.2018

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për shoqërinë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në lidhje me administrimin e likuiditetit të fondeve të investimeve.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo Rregullore hartohet në bazë të nenit 14, shkronjat c dhe ç të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 14 si dhe nenit 87, pika 6, të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 3
Fusha e veprimit

Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha fondet e investimeve të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Rregulloreje me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Treg aktiv” është një treg në të cilin transaksionet për aset në fjalë ndodhin me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm, për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme, dhe frekuenca e shkëmbimeve e volumi i këtyre shkëmbimeve është i mjaftueshëm për të mundësuar një fond për të likuiduar të gjithë pasurinë e tij në atë aset brenda 30 ditëve;

2. “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
3. “Fond” është fondi i investimeve sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
4. “Ligji” është Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
5. “Rreziku i likuiditetit” është rreziku i humbjes kur një pozicion asetit në portofolin e fondit nuk mund të shitet, likuidohet apo mbyllet me kosto sa më të ulët brenda një harku kohor mjaftueshmërisht të shkurtër, duke vënë në rrezik në këtë mënyrë aftësinë e fondit për të përmbushur detyrimet e tij për shlyerje, të përcaktuara në prospekt;
6. “Rreziku i Tregut” është rreziku i një fondi që lind nga luhatjet në vlerën e tregut të pozicioneve në portofolin e fondeve që lidhen me ndryshimet në variabla të tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e aksioneve dhe të mallrave apo vlerësimi i rrezikut të kreditit të emëtuesit;
7. “Mjet ose marrëveshje e veçantë” nënkupton një procedurë ose marrëveshje që lind si pasojë e drejtpërdrejtë e natyrës jolikuide të aseteve të një fondi që ndikon tek të drejtat specifike të shlyerjes së investitorëve në njësitë e fondit dhe që është një porosi e posaçme ose marrëveshje e veçantë nga të drejtat e përgjithshme të shlyerjes së investitorëve. Përdorimi i mjeteve dhe i marrëveshjeve të veçanta për administrimin e likuiditetit varet nga rrethanat konkrete dhe lejohet të ndryshojë sipas natyrës, shkallës dhe strategjisë së investimeve të fondit. Pezullimi i shlyerjes së kuotave të fondit nuk duhet të konsiderohet si një marrëveshje e veçantë, pasi kjo zbatohet për të gjithë asetet dhe investitorët e fondit;
8. “Asetet Likuide të Cilësisë së Lartë” (ALCL) janë ato asete që kanë një histori të dëshmuar likuiditeti, si në kushte normale të tregut ashtu dhe në kushte të një tensioni të lartë në treg. Më poshtë është një listë joshteruese e ALCL:
 - a. Mjetet monetare ose depozitat të cilat mund të tërhiqen pa penalitet;
 - b. Ekspozimet ndaj bankave të licencuara nga një bankë qendrore ose rregullatorë të tjerë bankarë në formën e instrumentave të tregut të parasë ose depozita me një maturim të mbetur deri në 7 ditë;
 - c. Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me një maturim të mbetur deri në 14 ditë, me kusht që letrat me vlerë të vendosura si kolateral sipas marrëveshjes të anasjelltë të riblerjes përmbushin kriteret e mëposhtme:
 - Letrat me Vlerë të Qeverisë Shqiptare me një maturim të mbetur deri në 90 ditë; ose
 - Letrat me Vlerë të Transferueshme në mënyrë që të përmbushë kriterin e përcaktuar në nenin 4 (f) dhe (g).
 -
 - d. Asete për të cilat dëshmohet se sasi të mjaftueshme të tyre mund të vendosen si kolateral nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes ose lehtësive kredituese midis fondit të investimit dhe Bankës së Shqipërisë, të cilat nuk janë subjekt i kufizimeve shtesë në rrethana tensioni të përgjithshëm në treg;
 - e. Obligacione qeveritare ose bono thesari me një maturim të mbetur deri në një muaj duke përfshirë kuponat;

- f. Titujt e transferueshëm që përfaqësojnë të drejta kundrejt ose të drejta të garantuara nga:
- i. Qeveritë qendrore, bankat qendrore dhe subjekte të sektorit shtetëror të cilat nuk janë njësi të qeverisjes qendrore (PSE), të vendeve anëtare të OECD-së, me një vlerësim afatgjatë të kreditit të vendit sipas S&P të paktën BBB- ose vlerësimet ekuivalente të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
 - ii. Qeveritë qendrore, bankat qendrore dhe subjektet e sektorit shtetëror, të cilat nuk janë njësi të qeverisjes qendrore të shteteve të tjera, me vlerësim krediti afatgjatë të vendit sipas S&P jo më pak se A+, ose vlerësimin ekuivalent të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
 - iii. Institucionet financiare në formën e obligacioneve të garantuara me kolateral (covered bonds) për aq kohë sa përmbushen kriteret e mëposhtme: obligacionet kanë një vlerësim S&P afatgjatë A + ose vlerësimin ekuivalent të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
 - iv. Banka për Shlyerjet Ndërkombëtare (BIS Basel), Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe të tjera si:
 - Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD);
 - Banka Europiane e Investimeve (EIB);
 - Banka Islamike për Zhvillim (ISDB);
 - Banka Aziatike për Zhvillim (ADB);
 - Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH);
 - CAF - Banka për Zhvillim për Amerikën Latine (CAF);
 - Grupi Ndër-Amerikan Bankar për Zhvillim (IDB, IADB);
 - Banka Afrikane për Zhvillim (AFDB);
 - Banka Aziatike e Investimeve Infrastrukturore (AIIB).
 - v. Fondi European për Stabilitetin Financiar (EFSF) dhe Mekanizmi për Stabilitetin European (ESM);
- g. Emetimet e korporatave si tituj borxhi kur këto plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:
- i. Kanë një vlerësim afatgjatë të S&P të BBB- ose vlerësimet ekuivalente të kreditimit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
 - ii. Pranohen për tregtim në një bursë të njohur ose një platformë tregtare shumëpalëshe;
- h. Emetuesit e korporatave në formën e aksioneve, me kusht që aksionet të jenë përbërës të një indeksi që përfshin kompanitë më të mëdha në një vend anëtar të OECD;

- i. Derivatet e tregtueshme në Bursa të cilat tregtohen në tregjet e rregulluara që kanë një mekanizëm *klering-u* në përputhje me pikën 72 të nenit 4 (1) të Rregullores (EU) nr. 575/2013; dhe tregjet e rregulluara që kanë një mekanizëm *kleringu* ku kontratat e listuara në Aneksin II të Rregullores (EU) nr. 575/2013 tregtohen dhe u nënshtrohen kërkesave të marzhit ditor që sigurojnë mbrojtje të përshtatshme sipas opinionit të autoriteteve kompetente në përputhje me pikën 72 të nenit 4 (1) të Rregullores (BE) nr. 575/2013.

Kuotat ose aksionet në Skemat e investimeve kolektive të cilat cilësohen si UCITS sipas direktivës 2009/5/EC të cilat mund të shlyhen në cdo ditë pune, ose kuota në fonde të mbyllura të krijuara si shoqëri aksionere të listuara dhe tregtuara në një bursë të rregulluar ose një platformë shumëpalëshe të tregtimit (MTF).

9. “Problemet financiare” nënkupton një situatë kur një kompani nuk mund të plotësojë ose ka vështirësi në shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj kreditorëve të saj.

10. “Prova e rezistencës” (*Stress testing*) është një teknikë simulimi që përdoret për portfolet e aseteve dhe të detyrimeve për të përcaktuar ndikimin në to në situata të ndryshme financiare. Provat janë modele simulimi që testojnë reagimin sipas skenarëve hipotetikë. Provat e rezistencës përdoren gjithashtu për të vlerësuar se si do të ndikojnë faktorët të caktuar në një kompani apo industri.

11. Titull bazë “Underlying security”, është termi që përdoret në tregtimin e derivateve, për të treguar asetin apo titullin në të cilin bazohet derivati. Aseti apo detyrimi bazë është instrumenti financiar, i tillë si një aksion, mall, monedhë, indeks, kontratë me afat (future), në çmimin e të cilit bazohet çmimi i derivatit.

12. “Plani i kontingjencës” nënkupton dokumentin e miratuar nga shoqëria administruese, që përcakton qartë politikat dhe procedurat që duhet të zbatohen në një situatë krize dhe ngritjen e fondeve emergjente.

13. “I pa bllokuar” (unencumbered) - do të thotë pa kufizime ligjore, rregullatore, kontraktuale ose të tjera mbi aftësinë e shoqërisë administruese për likuidimin, shitjen, transferimin ose caktimin e aktivitetit.

Neni 5

Administrimi i likuiditetit

1. Shoqëria administruese duhet të jetë në gjendje t’i provojë Autoritetit se ka një sistem të përshtatshëm të administrimit të likuiditetit dhe procedura efikase të cilat i përshtaten strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe politikës së shlyerjes për çdo fond që administron.

2. Shoqëria administruese, për secilin fond investimesh që administron, duhet të miratojë procedura që i mundësojnë monitorimin e rrezikut të likuiditetit dhe të kryejë rregullisht provat e rezistencës, në kushte normale dhe të jashtëzakonshme të likuiditetit, të cilat përfshijnë skenarë ekstremë por të besueshëm të rënies së likuiditetit.

3. Sistemi i administrimit të likuiditetit dhe procedurat e përmendura në nenin 5, duhet të sigurojnë minimalisht që:

a. Shoqëria administruese ruan një nivel të likuiditetit në fondin e investimit, në përputhje me detyrimet themelore të tij, bazuar në vlerësimin relativ të likuiditetit të aseteve të fondit të investimit në treg, duke marrë parasysh kohën që nevojitet për shlyerjet dhe çmimin ose vlerën me të cilën këto asete mund të shlyhen si dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj risqeve ose faktorëve të tjerë të tregut;

b. Shoqëria administruese monitoron profilin e likuiditetit të portofolit të aseteve të fondit të investimit, duke pasur parasysh kontributin e shtuar të aseteve individuale të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në likuiditetin e fondit, si dhe detyrimet dhe angazhimet materiale, të kushtëzuara ose jo, që fondi i investimit mund të ketë në raport me detyrimet bazë. Për këtë qëllim shoqëria administruese duhet të marrë parasysh profilin e bazës së investorëve të fondit të investimeve, duke përfshirë llojin e investorëve, madhësinë relative të investimeve dhe kushtet e shlyerjes ndaj të cilave këto investime janë subjekt;

c. Shoqëria administruese, në rastet kur fondi i investimeve investon në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive, duhet të kryejë rishikime periodike për të monitoruar ndryshimet në dispozitat e shlyerjeve që kanë sipërmarrjet e investimeve kolektive ku investon fondi i investimeve të cilat mund të ulin likuiditetin e tij;

d. Shoqëria administruese zbaton dhe përditëson rregulla dhe procedura të përshtatshme për matjen e likuiditetit, për të vlerësuar rreziqet sasiore dhe cilësore të pozicioneve dhe investimeve të synuara të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm në profilin e likuiditetit të portofolit të aseteve të fondit të investimit për të mundësuar matjen në mënyrë të përshtatshme të efekteve të tyre në profilin e përgjithshëm të likuiditetit. Procedurat e përdorura duhet të sigurojnë që shoqëria administruese të ketë njohuritë e duhura për të kuptuar likuiditetin e aseteve në të cilat fondi i investimit ka investuar ose synon të investojë duke përfshirë, aty ku është e mundur, vëllimin e tregtimit dhe ndjeshmërinë e çmimeve dhe sipas rastit, diapazonet e çmimeve të aseteve individuale në kushte likuiditeti normale dhe të jashtëzakonshme;

e. Shoqëria administruese mban një minimum të aseteve likuide për çdo fond që administron (ose masa të tjera të miratuara) kur kërkohet nga përcaktimet e nenit 10.

4. Shoqëria administruese duhet të dokumentojë politikën dhe procedurat e administrimit të likuiditetit, t'i rishikojë ato të paktën një herë në vit dhe t'i përditësojë ato sa herë që ka ndryshime ose krijohen rrethana të reja dhe t'i dorëzojë ato pranë Autoritetit, brenda 3-mujorit të parë të vitit.

5. Shoqëria administruese përshkallëzon masat e duhura në sistemin dhe procedurat e administrimit të likuiditetit për të trajtuar si duhet mungesën aktuale ose të pritshme të likuiditetit ose situata të tjera tensioni në fondin.

Neni 6

Kufijtë e menaxhimit të likuiditetit

1. Shoqëria administruese, në rast se kërkohet, duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e secilit fond investimesh që administron, përdor dhe përditëson kufij të mjaftueshëm për nivelin e likuiditetit ose të aseteve jo likuide të fondit të investimit, në përputhje me detyrimet bazë dhe politikën e shlyerjes, si dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet 9, 10 dhe 11 të kësaj rregulloreje.

2. Shoqëria administruese duhet të monitorojnë përputhshmërinë me këta kufij dhe në rastet kur këto kufij tejkalohen/shkelen ose kanë gjasa të tejkalohen/shkelen, ndërton planin e nevojshëm të veprimit dhe e dërgon menjëherë në Autoritet. Në përcaktimin e veprimeve të përshtatshme, shoqëria administruese duhet të marrë në konsideratë përshtatshmërinë e politikave dhe procedurave të administrimit të likuiditetit, përshtatshmërinë e profilit të likuiditetit të aseteve të fondit të investimit dhe ndikimin që ka paraqitja e kërkesave për shlyerje në nivele jo të zakonshme.

Neni 7

Prova e rezistencës (*Stress testing*)

1. Për çdo fond investimi duhet të zbatohen procedura të përshtatshme të provave të rezistencës për identifikimin e ngjarjeve të mundshme apo ndryshimeve të ardhshme në kushtet ekonomike që mund të kenë efekte të pafavorshme në fondin e investimeve. Menaxheri i një fondi investimesh duhet të kryejë rregullisht provat e rezistencës dhe të ndërtojë plane veprimi për skenarë të ndryshëm të mundshëm.
2. Provat e rezistencës duhet të bazohen në kritere objektive, duke marrë parasysh skenarë të besueshëm të situatave të rënda dhe ndikimet që kanë ato, si dhe:
 - a. Të kryhen në bazë të informacionit të besueshëm dhe të përditësuar nga ana sasiore ose, kur kjo nuk është e përshtatshme, nga ana cilësore;
 - b. Kur është e përshtatshme, të simulojnë mungesën e likuiditetit të aseteve në fondin e investimeve dhe kërkesat për shlyerje në nivele jo të zakonshme;
 - c. Të trajtojnë ndryshimet në nivelin e rrezikut të kreditit të aseteve të mbajtura në portofolin e fondit të investimit, duke përfshirë ngjarjet e kreditsë dhe ngjarjet e vlerësimit të kreditit;
 - d. Trajtojnë lëvizjet hipotetike të normave të interesit;
 - e. Trajtojnë rreziqet e tregut dhe çdo ndikim që rezulton, duke përfshirë edhe kërkesë për depozitim shtesë, kërkesat për kolateral apo revokimin e linjave të kreditit;
 - f. Të marrin parasysh ndjeshmërinë e vlerësimit në kushtet e tensionit; dhe
 - g. Të kryhen më një frekuencë që i përshtatet natyrës së fondit të investimeve, duke marrë parasysh strategjinë e investimeve, profilin e likuiditetit, llojin e investitorit dhe politikat e shlyerjes së fondit të investimit.
3. Modeli i provës së rezistencës të përdorur dhe çdo ndryshim i mëvonshëm i tij do të miratohet nga Autoriteti.
4. Kur nga provat e rezistencës rezulton se rreziku i likuiditetit është në masë të konsiderueshme më i lartë se rreziku i pritshëm i likuiditetit, shoqëria administruese, për të forcuar kapacitetin e likuiditetit, duhet të veprojë në interesin më të mirë të të gjithë investitorëve të fondeve duke marrë parasysh profilin e likuiditetit të aseteve të fondit, nivelin e kërkesave për shlyerje dhe kur është e përshtatshme mjaftueshmërinë e politikave dhe procedurave për administrimin e likuiditetit.

5. Kur nga provat e rezistencës rezulton ndonjë dobësi në fond, menaxheri i fondit të investimeve duhet të marrë masa për të forcuar qëndrueshmërinë e fondit të investimeve, duke përfshirë masa që përforcojnë likuiditetin ose cilësinë e aseteve të fondit të investimeve.
6. Administratorët e fondit i paraqesin këshillit të administrimit të shoqërisë administruese dhe Autoritetit një raport të hollësishëm me rezultatet e provave të rezistencës. Nëse rezulton e nevojshme, këshilli i administrimit duhet të ndryshojë planin e masave të propozuar dhe të miratojë planin përfundimtar. Raporti që përshkruan rezultatet e provave të rezistencës dhe plani i masave duhet të hartohen në formë të shkruar dhe duhet të ruhen minimalisht për një periudhë prej pesë (5) vjetësh.

Neni 8

Plani i Kontigjencës

Shoqëria administruese, për secilin fond që administron, duhet të krijojë një plan emergjence për administrimin e rrezikut të likuiditetit në kushte të stresuara. Ky plan duhet të rishikohet me frekuencë vjetore dhe të përditësohet në përputhje me rrethanat:

Plani i emergjencës duhet të jetë pjesë e politikave dhe procedurave të administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe duhet të përfshijë:

- Specifikimin e qartë të detyrave, kompetencave dhe vendimmarrjes në këndvështrimin e zbatimit praktik;
- Treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjale për shfaqjen e një situatë të tensionuar;
- Ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësi të raportimit;
- Kushtet në të cilat plani duhet të zbatohet;
- Veprimet që mund të ndërmerren;
- Burimet konkrete të likuiditetit në kushte stresi;
- Komunikimi me aktorët kryesorë, si p.sh. aksionarët, kuota-mbajtësit, rregullatorët, palët homologe dhe publiku i gjerë.

Neni 9

Bashkërendimi i strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe shlyerjeve

1. Shoqëria administruese siguron që, për çdo fond investimesh që administron, strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika e shlyerjes të jenë të bashkërenduara me njëra tjetrën. Strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika e shlyerjes e secilit fond investimi të administruar nga një shoqëri administruese, konsiderohen të bashkërenduara kur investitorët mund të shlyejnë investimet e tyre në përputhje me trajtimin e drejtë të të gjithë investitorëve të fondeve të investimit dhe në zbatim të politikës së shlyerjes dhe detyrimeve të fondit.

2. Për të vlerësuar bashkërendimin e strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe politikës së shlyerjes, shoqëria administruese duhet të mbajë parasysh edhe ndikimin që mund të kenë shlyerjet në çmimet bazë ose diapazonet e cmimeve të aseteve individuale të fondit të investimit.

Neni 10

Kërkesat për të ruajtur një nivel të Aseteve Likuide

1. Fondi duhet të mbajë në çdo kohë një nivel të mjaftueshëm të *ALCL* siç përcaktohet në nenin 4 dhe reflekton përbërjen e detyrimeve sipas monedhës, për të dhënë siguri të arsyeshme se fondi është në gjendje të:
 - a. Përbushë në çdo moment kërkesat për shlyerje, në përputhje me kushtet e përcaktuara në prospekt;
 - b. Të respektojë detyrimet e tjera, të cilat ligjërisht duhet t'i përbushë;
 - c. Të respektojë detyrimet e tjera, mospërbushja e të cilave sipas detyrimeve kontraktuale (p.sh. thirrjet e marzhit) dëmton interesat e investitorëve në fond.
2. Në çdo kohë, niveli i kërkuar i *ALCL* (rezervë likuiditeti - liquidity buffer) i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni nuk duhet të jetë më i vogël se vlera më e lartë e:
 - a. 10% të aseteve neto të fondit; ose
 - b. Vlera bruto e flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit deri në datën e llogaritjes, e cila duhet të jetë e përditësuar (flukset hyrëse nuk zbriten për qëllimet e llogaritjes së flukseve dalëse).
3. Asetet që përbëjnë rezervën e likuiditetit (*Liquidity Buffer*) duhet të mbahen në monedhën në të cilën janë shprehur kuotat e fondit dhe në të cilën kërkohet të kryhen shlyerjet dhe të paktën 50% e rezervës duhet të mbahet në mjete monetare dhe/ose instrumente financiare me periudhë të mbetur në maturim jo më të gjatë se 7 ditë dhe pjesa e mbetur 50% duhet të mbahet në asete të cilat plotësojnë kërkesat e përcakufizimit të *ALCL* në nenin 4, paragrafi 7.
4. Nëse një fond ka më shumë se 50% të aseteve të tij të investuara në *ALCL* që përbushin kërkesat e pikës 7, të nenit 4, të kësaj rregulloreje dhe në rastin e aseteve të investuara sipas shkronjave (f), (g), (h) dhe (i) të po të njëjtës pikë, të cilat tregtohen në tregje aktive (Shih Shtojcën I), atëherë fondi nuk ka detyrim të përbushë kërkesat e pikës 3, të këtij neni.

Neni 11

Aftësia për të përbushur kërkesat e likuiditetit

Për të përbushur kërkesat e kësaj rregulloreje, shoqëria administruese e fondit të investimeve duhet të sigurojë të gjitha kapacitetet e nevojshme financiare, teknike, organizative dhe burimet njerëzore dhe duhet të rishikojë përshtatshmërinë e tyre në mënyrë të rregullt.

Neni 12

Përputhshmëria me kërkesat e likuiditetit

1. Pavarësisht nga detyrimi për mbajtjen në çdo kohë të një niveli të ALCL, në periudha tensioni fondi mund të jetë i detyruar të kryejë pagesa të menjëhershme, të cilat mund të shkaktojnë një rënie në likuiditetin e kërkuar nën 10%, sipas kërkesës së pikës 3, neni 10 i kësaj rregulloreje.
2. Kur niveli i likuiditetit të një fondi investimi bie ose në mënyrë të besueshme pritët të bjerë nën atë limit, shoqëria administruese duhet të:
 - a. njoftojë menjëherë Autoritetin;
 - b. depozitojë menjëherë në Autoritet një plan masash për përmirësimin në kohë të kërkesave të likuiditetit dhe përmbushjes së kërkesave të nenit 9;
 - c. raportojë në Autoriteti çdo ditë deri në fund të çdo dite pune, përveç rasteve kur Autoriteti autorizon një frekuencë më të ulët raportimi dhe një periudhë më të gjatë të raportimit.
3. Autoriteti monitoron zbatimin e planit të masave, të përcaktuar në shkronjën b, të pikës 2 të këtij neni dhe nëse e gjykon të arsyeshme, kërkon përsheptimin e procesit të rikuperimit.

Neni 13

Raportimi në Autoritet

1. Shoqëria administruese, për secilin fond investimi që administron duhet të raportojë në Autoritet çdo vit, brenda tremujorit të parë dhe sa herë që Autoriteti e kërkon ose ka ndryshime, informacionin mbi ndryshimet e supozimeve dhe rezultatet e provave të rezistencës (*stress testing*), si dhe planin e veprimit të miratuar nga këshilli i administrimit të shoqërisë adminitruese.
2. Shoqëria administruese e fondit të investimit, për secilin fond që administron, raporton në Autoritet çdo dy javë informacionin mbi shlyerjet.
3. Nëse e gjykon të arsyeshme, Autoriteti mund të kërkojë informacion shtesë ose raportim më të shpeshtë për kërkesat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 14

Miratimi i Autoritetit

Miratimi i të gjithë elementëve të përcaktuar në këtë rregullore për miratim nga Autoriteti, është kompetencë e Bordit të Autoritetit.

Neni 15

Dispozita kalimtare

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen pa dallim nga të gjitha fondet e licencuara për të vepruar në territorin e Republikës së Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, brenda një periudhe 6 mujore nga data e hyrjes në fuqi të saj. Këto fonde paraqesin në Autoritet planin e arsyetuar për përputhshmërinë me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e këtij plani, brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi të saj.

SHTOJCA I

Lista e bursave aktive dhe indekseve

Për qëllimin e kësaj rregulloreje, letrat me vlerë të tregtuara në bursat, platformat tregtare shumëpalëshe dhe indekset e mëposhtme, do të konsiderohen si letra me vlerë të tregtuara në tregun aktiv.

1. Bursat dhe OTCs (*Over the Counter*) – Tregjet mbi banak

Bursa Australiane

BME - Bursa Spanjolle

Bursa e Frankfurtit

Bursa e Hong Kongut

Bursa e Italisë

Bursa e Koresë

Bursa e Londrës

NASDAQ

Bursa e Nju Jorkut / Euronext

Bursa e Zelandës së Re

Bursat OMX Nordic

Bursa SËX Zvicran

Bursa e Shangait

Bursa Shenzhen

Bursa e Tokios

Bursa e Torontos

2. Indekset

AEX-Index

Amex

Indeksi CAC 40

CAC Tjetra 20

Deutsche Boerse AG German Stock Index DAX- Indeksi i Aksioneve në Gjermani DAX

Dow Jones & Company

EURO STOXX 50 Çmimi EUR

Indeksi

Indeksi i FTSE 100

Indeksi i FTSE MIB

Indeksi FTSE MID 250

Indeksi Hong Kong i Hang Seng

Indeksi IBEX 35

JPX400

Indeksi Lux - Bursa e Luksemburgut

MICEX

MSCI

Nikkei 225

Indeksi OBX

Indeksi OMX Stockholm 30

RTSI

Indekset Russell

SBF 250

Standard & Poor's

S & P / ASX 200

Indeksi i Tregut të Zvicrës

Topix